

BILANCI I PAGESAVE¹

Përmbajtja

Llogaria korrente	2
Tregtia e mallrave	3
Tregtia e shërbimeve	3
Të ardhurat parësore	4
Të ardhurat dytësore	5
Llogaria kapitale	5
Llogaria financiare	5

Kryesore:

Në tremujorin e parë të vitit 2019:

- Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në rreth 243 milionë euro, i zgjeruar në terma vjetorë.
- Llogaria e shërbimeve vlerësohet në një balancë pozitive prej rreth 289 milionë euro, në rritje në terma vjetorë.
- Fluksi i investimeve të huaja direkte, në formën e zgjerimit të kapitalit vlerësohet në 266 milionë euro.
- Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emigrantët shënuan 150 milionë euro.
- Stoku i rezervës valutore në fund të periudhës vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 6.8 muaj importe në mallra dhe shërbime.

Në tremujorin e parë të vitit 2019, *deficiti i llogarisë korrente*, shënon 243 milionë euro. Në terma vjetorë, deficiti korrent u zgjerua me rreth 41%.

Thellimi i deficitit korrent në masën më të madhe është diktuar nga zgjerimi i *deficitit tregtar* në mallra—në reflektim të rritjes së shpenzimeve për importe dhe rënies së eksporteve. Në të njëjtën kohë, zgjerimi i balancës negative të të *ardhurave parësore* dhe rënia e suficitit në të *ardhurat dytësore* kanë mbështetur thellimin e deficitit korrent.


Deficiti tregtar (mallra dhe shërbime) u zgjerua me rreth 13%, në nivelin 406 milionë euro.

Fluksi hyrës neto në *llogarinë financiare* (pa përfshirë mjetet e rezervës) shënon 289 milionë euro dhe mbulon plotësisht deficitin korrent. Flukset hyrëse neto në *llogarinë financiare* janë mbështetur nga zgjerimi i detyrimeve neto në formën e investimeve direkte, si dhe fluksit neto pozitiv të detyrimeve të investimeve të tjera.

Duke reflektuar ecurinë e llogarisë korrente dhe zhvillimeve në llogarinë kapitale e financiare, *mjetet e rezervës* ranë me rreth 71 milionë euro, në nivelin 3,353 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 6.8 muaj importe të mallrave dhe shërbimeve.

Në terma vjetorë, transaksionet financiare gjatë periudhës, rezultuan në zgjerim të *detyrimit financiar* të Shqipërisë me botën me rreth 96%.

*Shkalla e ekspozimit*² të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 226 milionë euro, në rritje me 72 milionë euro referuar nivelit në një vit më parë.



Grafik 1. Llogaria korrente dhe flukset financiare neto (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).
Shënim: Flukset financiare neto paraqiten sipas parimit të drejtimit të investimit.

1. Të dhënat janë hartuar bazuar në metodologjinë e FMN "Manuali i Bilancit të Pagesave, Botimi i 6-të". Bilanci i Pagesave (BP) regjistron të gjitha transaksionet ekonomike të ndodhura midis njërive rezidente dhe jorezidente, gjatë një periudhe të dhënë kohe.

2. Bilanci i llogarisë korrente së bashku me bilancin e llogarisë kapitale përcakton shkallën e ekspozimit të ekonomisë shqiptare me pjesën tjetër të botës, ndërsa llogaria financiare shpjegon si është financiar ky ekspozim.

LLOGARIA KORRENTE

Gjatë periudhës, vëllimi i *transaksioneve korrente* shënon 2,610 milionë euro, në rritje me rreth 7% në terma vjetorë. Deficiti i *llogarisë korrente* vlerësohet në 243 milionë euro, rreth 41% më i lartë krahasuar me një vit më parë.

Thellimi i *deficitit korrent*, reflekton zgjerimin e deficitit tregtar të mallrave dhe balancës negative të të *ardhurave parësore*, pasojë e ecurisë në rritje të riatdhësisimit të fitimeve dhe dividendëve.

Deficiti tregtar u thellua me rreth 13% në terma vjetorë, si pasojë njëkohësisht e rritjes së importeve dhe rënies në eksporte. Rritja në importin e mallrave është pasojë e flukseve të larta të importeve në minerale, lëndë djegëse e energji dhe produkte të industrisë kimike. Ndërkohë, rënia e eksportit të mallrave është diktuar nga rënia në eksportet e energjisë elektrike dhe metaleve bazë.

Ndërkohë, suficiti i *tregtisë në shërbime* është zgjeruar me 13%, kryesisht për rrjedhojë të rritjes së flukseve hyrëse në “*shërbime për përpunim*” dhe “*shërbime të tjera biznesi*” si dhe tkurrjes së pagesave të kryera nga qeveria në formën e asistencës teknike (shërbime qeveritare).

Deficiti tregtar në mallra dhe shërbime u zgjerua me rreth 13% në terma vjetorë, në nivelin 406 milionë euro.

Gjatë periudhës, rreth 90% e shpenzimeve korrente³ kanë shkuar për financimin e importeve të mallrave dhe shërbimeve, ndërkohë që hyrjet valutore⁴ janë siguruar kryesisht nga eksportet e shërbimeve (në masën 57%) dhe ato të mallrave dhe të ardhurat dytësore (së bashku për rreth 36%).

Thellimi i deficitit korrent u ndikua kryesisht nga (i) thellimi i deficitit tregtar (në mallra); (ii) zgjerimit të balancës negative të të ardhurave parësore.

	Shuma rrëshqitëse e katër-tremujorëve							
	T1 2018			T1 2019			T1 2018	T1 2019
	Balanca	Kredi	Debi	Balanca	Kredi	Debi	Balanca	Balanca
Llogaria korrente	881	5,108	5,988	931	5,500	6,430	-172	-243
<i>në përqindje ndaj PBB</i>	-7%	43%	50%	-7%	42%	49%		
Mallra	2,852	834	3,686	2,951	977	3,928	-615	-694
Shërbime	1,061	2,886	1,825	1,138	3,118	1,980	255	289
Shërbime për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët	345	346	2	430	432	2	107	123
Transport	30	237	206	32	250	218	8	-5
Udhëtime	448	1,737	1,289	429	1,874	1,445	78	76
Shërbime telekomunikacioni, kompjuteri dhe informacioni	8	78	70	10	78	69	5	7
Shërbime të tjera biznesi	332	401	69	320	396	76	78	92
Shërbime dhe mallra qeveritare	80	36	116	35	45	80	-18	6
Shërbime të tjera	22	51	73	48	42	91	-3	-10
Të ardhura parësore	29	400	371	20	406	426	-15	-29
Të ardhura nga puna	269	290	21	288	314	27	44	47
Të ardhura nga investimet	241	106	347	308	88	396	-59	-76
Investime direkte	242	25	267	290	11	302	-63	-72
Investime portofoli	0	19	19	6	24	18	5	7
Investime të tjera	32	29	61	51	25	76	-10	-17
Mjetet e rezervës	33	33		28	28		9	8
Të ardhura të tjera parësore	0	4	3	1	4	3	0	0
Të ardhura dytësore	881	988	106	901	998	97	203	191
Të ardhura nga emigrantët	649	650	0	671	672	1	149	150

Tabela. Ecuria e përbërësve të llogarisë korrente (shuma rrëshqitëse e katër tremujorëve)

³ Shpenzimet korrente përfshijnë importin e mallrave, importin e shërbimeve, daljet në të ardhurat parësore dhe daljet në të ardhurat dytësore.

⁴ Hyrjet valutore përfshijnë eksportin e mallrave, eksportin e shërbimeve, hyrjet në të ardhurat parësore dhe hyrjet në të ardhurat dytësore.




TREGTIA E MALLRAVE

Vëllimi i përgjithshëm i shkëmbimeve tregtare u zgjerua me 6% në nivelin 1,113 milionë euro dhe përbën 43% të transaksioneve korrente.

Në terma vjetore, eksportet kanë shënuar rënie prej 4%, në nivelin 210 milionë euro. Importi i mallrave shënon 904 milionë euro me rritje prej 9%.

Thellimi i deficitit tregtar në mallra, këtë tremujor reflekton rritjen e importeve të produkteve minerare dhe të industrisë kimike, e mbështetur edhe nga rënia e eksporteve po në produkte minerare dhe në metale bazë.

Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet vlerësohet në nivelin 23%, ose 3 pikë përqindje më pak se një vit më parë.



Grafik 2. Ecuria e tregtisë në mallra (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

Thellimi i deficitit të tregtisë në mallra është kryesisht pasojë e importeve të larta të produkteve minerare.

TREGTIA E SHËRBIMEVE

Tregtia në shërbime, gjatë periudhës, u mbyll me një balancë pozitive prej 289 milionë euro, me rritje 13% në terma vjetorë.

Ecuria e llogarisë së shërbimeve është ndikuar pozitivisht nga flukse hyrëse në "shërbime për përpunim" dhe nga rënia e pagesave të kryera nga qeveria në formën e asistencës teknike (shërbime qeveritare). Gjithashtu, kontribut pozitiv kanë dhënë flukset hyrëse në "shërbime të tjera biznesi".

Shërbimet e udhëtimit u mbyllën me bilanc pozitiv prej 76 milionë euro, lehtësisht në rënie me 2% në terma vjetorë. Sëbashku, të ardhurat dhe shpenzimet në këtë kategori janë zgjeruar me respektivisht me 5% dhe 7%. Shërbimet e udhëtimit zënë peshën më të madhe në flukset hyrëse dhe dalëse të regjistruara nën llogarinë e shërbimeve – me 52% të të ardhurave dhe 71% të shpenzimeve të saj.



Shërbimet e udhëtimit kryesojnë në fluksin hyrës dhe dalës të llogarisë së shërbimeve – me 52% të të ardhurave dhe 71% të shpenzimeve të saj.

Gjatë tremujorit të parë 2019, eksporti i shërbimeve të udhëtimit i ka siguruar ekonomisë vendase rreth 348 milionë euro. Rritja vjetore e të ardhurave u ndikua nga rritja e numrit të vizitorëve të huaj (jorezidentë) me 5%.

Nga ana tjetër, udhëtarët rezidentë (shqiptarë dhe të huaj) kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë vendit 272 milionë euro. Në baza vjetore, numri i rezidentëve që kanë udhëtuar jashtë është rritur me 9%.

Bilanci pozitiv i “shërbimeve për përpunim të inputeve fizike⁵ të zotëruara nga të tjerët” u vlerësua në 123 milionë euro. Të ardhurat hyrëse të kësaj kategorie u zgjeruan në terma vjetorë me rreth 15% në nivelin 123 milionë euro dhe përfaqësojnë shërbime që ekonomia shqiptare i ofron partnerëve të huaj (jorezidentëve) për përpunimin e mallrave të zotëruara prej këtyre të fundit.


“Shërbime të tjera biznesi” rezultuan me bilanc pozitiv prej 92 milionë euro, në rritje vjetore prej 18%. Kjo kategori shërbimi i ka sjellë ekonomisë shqiptare rreth 109 milionë euro flukse valutore hyrëse.

TË ARDHURAT PARËSORE

Llogaria e të ardhurave parësore (puna dhe kapitali) u mbyll me fluks neto negativ prej 29 milionë eurosh. Në terma vjetorë, fluksin hyrës dhe ato dalës u rritën respektivisht me 11% dhe 26%.

Të ardhurat neto faktoriale nga puna, të cilat kryesojnë fluksin hyrës të të ardhurave parësore, vlerësohen në 47 milionë euro, me rritje 6% në terma vjetorë.

Të ardhurat nga investimet kanë thelluar bilancin negativ (flukse neto dalës), rreth 27% në terma vjetorë, në nivelin 76 milionë euro. Fluksi dalës prezantohet në formën e pagesave të dividendëve dhe fitimit të riinvestuar (78 milionë euro) si dhe pagesa interesash (23 milionë euro).



Grafik 3. Ecuria e të ardhurave parësore nga investimet (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).


⁵ Këtu përfshihet vëllimi i transaksioneve të kryera për industrinë e tekstileve dhe të artikujve tekstile, dhe te këpucëve (industria e përpunimit me lëndë të parë të huaj në vend).



TË ARDHURAT DYTËSORE

Të ardhurat dytësore u vlerësuan në 191 milionë euro, në rënie vjetore prej 6% e cila reflekton kryesisht ecurinë e granteve hyrëse drejt sektorëve të qeverisë, në formën e asistencës teknike.

Rreth 79% e të ardhurave dytësore përfaqësohet nga transfertat neto të “të ardhura nga emigrantët”. Sipas Bankës së Shqipërisë, prurjet valutore të emigrantëve gjatë këtij tremujori vlerësohen rreth të njëjtit nivel të një viti më parë, në rreth 150 milionë euro.



Grafik 4. Ecuria e të ardhurave dytësore dhe të ardhurat nga emigrantët (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

LLOGARIA KAPITALE

Llogaria kapitale regjistroi flukse neto pozitive, në nivelin 17 milionë euro, me rënie vjetore prej 5%, e ardhur kryesisht nga rënia në formën e granteve drejt sektorit të qeverisë së përgjithshme.

LLOGARIA FINANCIARE

Transaksionet financiare gjatë periudhës, rezultuan në një fluks hyrës ose zgjerim të detyrimit financiar të Shqipërisë me botën me rreth 289 milionë euro, nivel ky rreth 96% më i lartë referuar nivelit në të njëjtën periudhë një vit më parë.

Ky zhvillim pasqyron në masën më të madhe hyrjet në formën e *Investimeve direkte* ekonomisë shqiptare. Flukset jo borxh krijuese, në trajtën e *Investimeve direkte* u rritën në terma vjetorë me 2%.


Ndërkohë, zotërimet tona jashtë - mjetet financiare në formën e *Investimeve direkte* shqiptare jashtë, u rritën me 6 milionë euro.

Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emigrantët shënuan 150 milionë euro.




Fluksi i *Investimeve të huaja direkte* në formën e zgjerimit të kapitalit, vlerësohet në 266 milionë euro – të përqëndruara kryesisht në sektorin e energjitikës (në masën 49%), të hidrokarbureve (në masën 18%) dhe ndërmjetësimit financiar (në masën 8%).

Marrëdhëniet e borxhit mes kompanive të lidhura derivuan një fluks pozitiv prej 20 milionë euro, si pasojë e rritjes së detyrimeve.



Grafik 5. Llogaria financiare dhe fluksneto sipas kategorive përbërëse.



Grafik 6. Ecuria e fluksit të investimeve direkte - mjete dhe detyrime (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve)

Efekti neutral i *Investimeve të portofolit* në llogarinë financiare këtë tremujor, ka ardhur si pasojë e rënies së mjeteve në të njëjtën masë me rënien e detyrimeve. Transaksionet në *mjete* janë kryesuar nga sektori bankar, ndërsa në anën e *detyrimeve* sektori privat mban peshën kryesore.

Investimet e tjera shënuan rënie prej 9 milionë euro. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e tkurrjes së investimeve në “monedha dhe depozita” (-18 milionë euro) të sektorit bankar dhe tkurrjes së investimeve në “llogari të tjera të arkëtueshme/ të pagueshme” (-15) në sektorin bankar si detyrime të jorezidentëve.

Fluksi hyrës i investimeve direkte shënon 286 milionë euro, me zgjerim kapitali i përqëndruar kryesisht në sektorin e energjitikës, hidrokarbureve dhe të ndërmjetësimit financiar; marrëdhëniet e borxhit mes kompanive të lidhura derivuan një fluks pozitiv prej 20 milionë euro.





Grafik 7. Ecuria e fluksit të investimeve të portofolit dhe investimeve të tjera – mjete dhe detyrime (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

Mjetet e rezervës ranë me 71 milionë euro. Stoku i rezervës valutore në fund të periudhës shënon 3,353 milionë euro i mjaftueshëm për mbulimin e 6.8 muaj importesh mesatare në mallra dhe shërbime.

Stoku i rezervës valutore në fund të periudhës vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 6.8 muaj importe në mallra dhe shërbime.



**DEPARTAMENTI I
STATISTIKAVE
FINANCIARE**

Sheshi "Skënderbej", nr. 1, Tiranë

Tel: + 355 4 241 93 01
+ 355 4 241 93 02
+ 355 4 241 93 03
+ 355 4 241 94 09
+ 355 4 241 94 10
+ 355 4 241 94 11

Fax: + 355 4 241 94 08
Email: statistics@bankofalbania.org



Shënime:

Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën për të bërë rishikimin e statistikave të publikuara. Në rastin e rishikimeve që sjellin ndryshime të treguesve, Banka e Shqipërisë njihet përdoruesit me faktorët e rishikimit dhe ndikimin përkatës.

Gjatë periudhës nuk kanë ndodhur ndryshime në bilancin e pagesave si pasojë e rishikimeve.

Për më shumë informacion mbi të dhënat e bilancit të pagesave referojuni linkut të mëposhtëm:

https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Statistikat_e_Sektorit_te_Jashtem/Bilanci_i_Pagesave/Te_dhenat_kryesore_per_Bilancin_e_Pagesave.html